

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË CEREMONINË E DHURIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHQIPTARIT**

1 dhjetor 2011

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,
Zëvendësdyrektori të Përgjithshëm,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëdita!

Sot, kam kënaqësinë që, si Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, t'i dhuroj Policisë së Shtetit Shqiptar disa pajisje teknike të rëndësishme.

Besoj se këto pajisje do të ndihmojnë në përforcimin e mëtejshëm të luftës kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, si dhe për të forcuar kapacitetin në fushën e hetimit, identifikimit dhe parandalimit të krimeve.

Që prej ardhjes sime në Shqipëri, kam pasur kënaqësinë të jem dëshmitar i shumë zhvillimeve pozitive në Policinë e Shtetit. Profesionalizmi aktual i Policisë së Shtetit ka bërë progres të dukshëm bazuar në përkushtimin e palodhshëm të oficerëve të policisë në të gjitha nivelet.

Siç e kemi dëgjuar edhe në deklaratat publike, lufta kundër krimit të organizuar është një prioritet kryesor për vendin.

Çelësi i suksesit është që si qeveria, ashtu edhe Policia e Shtetit ta marrin këtë sfidë seriozisht, dhe siç e dimë të gjithë – ato po bëjnë pikërisht këtë gjë.

Krimi i organizuar përbën kërcënim për shoqërinë shqiptare. Por në aspekt edhe më të gjerë: ai ka pasoja serioze edhe për vende të tjera të Evropës e më tej. Për këtë arsye hapat e marra në këtë fushë janë një shërbim i rëndësishëm partneriteti në Evropën vazhdimisht në rritje.

Krimi i organizuar ka ndikim negativ në sigurinë e njerëzve, sepse pengon zhvillimin social, ekonomik, politik dhe kulturor të një shoqërie moderne.

Krimi i organizuar është një forcë e errët, shpeshherë teknikisht i sofistikuar, zakonisht me lidhje të mira e me shumë fitime, që i drejtohet korrupsionit, dhunës, dhe aktiviteteve ndërkufitare për të çuar më tej qëllimet e veta. Qytetarit paqedashës e që zbaton ligjin, të gjitha këto i hyjnë në punë po aq sa i hyjnë në punë murtaja e kolera.

Megjithatë, nëse Policia e Shtetit synon t'i kapërcejë me sukses këto sfida të vazhdueshme, do të kërkojnë trajnime dhe pajisje të specializuara.

Korrikun e vjetshëm, Prezenca u ofroi 20 oficerëve të policisë të Departamentit të Hetimit të Krimeve një Trajnim për Blerjen e Simuluar.

Për ta mbështetur këtë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dëshiron tashmë t'i dhurojë disa pajisje teknike për përdorim gjatë zhvillimit dhe menaxhimit të operacioneve të infiltuara të policisë.

Këto pajisje do të kenë për qëllim t'i ndihmojnë oficerët e policisë në sigurimin e provave që mund të përdoren në gjykatë.

Megjithatë, që kjo gjë të ndodhë me sukses, është shumë e rëndësishme që të zhvillohen e të ruhen linja të forta bashkëpunimi midis Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.

Drejtor i Përgjithshëm,
Zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm,
Zonja dhe zotërinj,

Për ta përmbledhur, do të doja të theksoja se për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri është gjithmonë kënaqësi dhe detyrë fisnike të mbështesë Policinë e Shtetit ndërsa ajo vazhdon të forcojë edhe më shumë kapacitetet e saj.

Ekipi im dhe unë personalisht do të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje të mëtejshme në të ardhmen.

Ju uroj të gjithëve shumë suksese në përpjekjet tuaja profesionale!

Shumë faleminderit!

Fund